



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 10.10.2018, me fillim në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit , salla N-302

PROCESVERBALI

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i komisionit, Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Haxhi Shala, Jasmina Zhivkoviç, Sasha Milosavljeviç, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Duda Balje, Slobodan Petroviç dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Kujtim Shala, Fadil Beka dhe Zoran Mojsiloviç,

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues i OSBE-së Senad Karaahmetovic; përfaqësues nga KDI-ja- Bleron Hoxha, përfaqësuese nga Ambasada Zvicrane,-Hajrudin Skenderi; gazetar Kallxo.com Mirjeta Vllahiu; gazetar nga AKTIV-ia – Ardita Hajra; gazetar të Radio Kosova – Drita Vitia; këshilltar i Sekretariatit të KKK-së Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Igor Simiq**, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.9.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-054 për gjykatat, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
7. **Të ndryshme.**
 1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L043 për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare.

Kryetari konstatoi se komisioni u pajtua, unanimisht, që të plotësohet rendi i ditës, me propozimin e dhënë më lart.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.9.2018

Kryetari konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 18.9.2018, u miratua, njëzëri, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, që të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Më tej, tha se ky projektligj është më se i nevojshëm, ngase rregullon procesin për mbrojtjen ekologjike. Gjithashtu, ofron mundësinë e importimit të automjeteve deri 15 vite, transformimin e bartjes së pronësisë së regjistrimit nga pronari që është blerë.

Pasi nuk pati diskutime shtesë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenohen dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari, duke pasur parasysh rëndësinë që ka Projektligji për Gjykatat dhe Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, tha se GP i Listës Serbe ka paraqitur amendamente në të dy projektligjet, ndërsa Komisioni funksional nuk i ka përkrahur. Këto janë arsyet, pse përfaqësuesit e GP-Lista Serbe, të përfaqësuar në strukturën e komisionit, deklarohen kundër miratimit të këtyre projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga Komisioni funksional.

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi nuk kishte propozime tjera, përkritazi me projektligjin dhe pas rezultatit të votimit: 10 për, 3 kundër, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Me shumicën e votave, Projektligjit nr. 06/L-054 për gjykatat, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenohen dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi nuk kishte diskutime shtesë për këtë projektligj dhe pas rezultatit të votimit: 10 për, 3 kundër, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Me shumicën e votave, Projektligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare, me amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-043 për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-043 për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

8. Të ndryshme

Kryetari, me qëllim të realizimit të aktiviteteve të planit të punës, në mbledhjen paraprake, janë akorduar anëtarët e komisionit, që të realizohen vizitat në terren, së paku dy komuna, në muaj. Si objektive tjetër është që grupet punuese, të fillojnë me procedurat e monitorimit të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit për financat e pushtetit lokal, si dhe raportimi i ministrave, që do të jetë njëra nga detyrat kyçe, në periudhën e ardhshme.

Duda Balje, propozim i saj konkret ishte që në procedurë të përshpejtuar, të ftohet në takim, ministri i MASHT-it, z. Shyqyri Bytyçi, me qëllim që të raportojë lidhur me vendet e rezervuara të studentëve të komunitetit joshumicë dhe vendeve të rezervuara në Qendrën e Studentëve. Përveç ministrit, të ftohet edhe drejtori i Qendrës Studentëve, i cili është përgjegjës për implementimin ligjor të vendeve të rezervuara për komunitetin joshumicë.

Veton Berisha, plotësisht e mbështet propozimin e dhënë të koleges Duda Balje, ngase mund të tejkalohen afatet kohore për regjistrimin e studentëve të komunitetit joshumicë, në Qendrën e Studentëve.

Xhelal Sveçla, ishte i mendimit që kjo çështje duhet që të shtjellohet si pikë e veçantë, në mbledhjen e radhës së komisionit.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Ngarkohet administrata për mbështetje të komisionit, që të ftojë në takim, ministrin e MASHT-it, z. Shqyeri Bytyçi, që të raportojë lidhur me çështjen e regjistrimit të pjesëtarëve të komunitetit shumicë për vendet e rezervuara të studentëve të komunitetit joshumicë dhe vendeve të rezervuara në Qendrën e Studentëve, për vitin akademik 2018/2019.

Veton Berisha, kërkoi të informohet nga administrata për mbështetje të komisionit, në cilën fazë gjendet procedimi i Ligjit për festat zyrtare të Republikës së Kosovës, pasi ne jemi Komision funksional, dhe kemi iniciuar ndryshimin dhe plotësimin e të njëjtit.

Si kërkesë tjetër me rëndësi është që komisioni t'i drejtohet me shkrim, ministrit për PMS, z. Skënder Reçica, që në procedurë të përshpejtuar të zbatojë implementimin e mjeteve buxhetore, i ndarë nga Buxheti i Kosovës, shumë e cila me iniciativën time është rritur prej 1.800.000€ në vlerë prej 2.400,000 €, në emër të ndërtimit të shtëpive për komunitetet joshumicë.

Në bazë të konkluzionit të miratuar, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Rekomandohet, që Ministria, me procedurë të përshpejtuar të zbatojë mekanizmat për implementimin e mjeteve të ndara buxhetore nga buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2018, në shumën prej 2.400,000 €, për përkrahjen e komunitetit boshnjak, egjiptian, ashkali, rom dhe turk, në pajtim me planin e ndërtimit të shtëpive për nevojat e tyre.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetar i komisionit,

Igor Simiq